



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
I MBAJTUR MË 12. 4. 2017

PRILL
2017

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisioni për Legjislacion, znj. Albulena Haxhiu

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Komisionit për Legjislacion,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve,
Përfaqësues të shoqërisë civile,
Media,

Ju faleminderit që keni ardhur në këtë dëgjim publik ku si diskutim e kemi Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Siç e dini ky projektligj është proceduar nga Qeveria rrjedhimisht nga Ministria e Drejtësisë në Komisionin për Legjislacion dhe Komisioni për Legjislacion e ka miratuar në parim. Po ashtu edhe seancën e Kuvendit është miratuar në parim ky projektligj.

Pastaj Komisioni për Legjislacion ka formuar grupin punues i cili grup punues drejtohet nga deputeti Agim Aliu ose Agim Ademaj më falni, për shkak se kemi shumë projektligje gjatë kësaj faze në shqyrtim dhe pastaj po ngatërrohen edhe drejtuesit.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik është që ta analizojmë draftin që e kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë po ashtu që të marrim vërejtjet e përfaqësuesve të institucioneve dhe shoqërisë civile për të njëjtin.

Ju e dini që është jashtëzakonisht vonë koha kur po e shqyrtojmë këtë projektligji për faktin se dy herë radhazi më parë është tërhequr nga procedura për asnjë arsytim Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit.

Në atë kohë kemi pasur plotësim ndryshim të Ligjit për konflikt interesi tashmë kemi projektligj të ri edhe pse në memorandumin shpjegues e patë përmend deputeti Agim Ademaj në memorandumin shpjegues thuhet që po bëhet fjalë për plotësim ndryshim, pastaj në tekst e kemi parë që është në fakt projektligj i ri.

Pra, deputetët e kanë shqyrtuar dhe analizuar edhe në seancë plenare, unë bashkërisht me deputetin Ismajl Kurteshi, kemi propozuar një amendament vetëm për hir të opinionit po e bëjë të qartë cili është amendamenti.

Është diskutua goxha gjatë fakti që zyrtarët e lartë sot në Republikën e Kosovës me gjithë papunësinë që është po kanë më shumë se një vend pune, dy, tri, katër, pesë madje ka zyrtarë të lartë që i ka edhe 5 vende pune dhe mendoj që ka ardhur koha dhe jemi në kohën e fundit kur këtë çështje duhet ta shqyrtojmë dhe analizojmë mirë.

Andaj, ne si deputetë të Lëvizjes kemi propozuar një amendament që zyrtari i lartë nuk mund të jetë i punësuar në një detyrë tjetër përveç detyrës që ushtron si zyrtar i lartë, pra të ketë vetëm një vend pune.

Më duhet me theksua faktin që kjo çështje është diskutua edhe në grupet punuese më përpara në Komisionit për Legjislacion dhe ka pasur një konsensus që kjo të adresohet, madje kemi përpiluar edhe një amendament sa që shumë prej nesh besojnë që qëllimi sepse është tërhequr dy herë radhazi ky projektligj nga procedurat ka qenë pikërisht për shkak të këtij amendamenti. Pra, dikujt si duket nuk po i konvenon që kjo çështje të ndalohet me ligj, pra që një zyrtar të mos mund të ushtroj më shumë se një funksion publik.

Andaj, kërkoj edhe kontributin tuaj edhe në këtë drejtim.

Unë po e hap debatin, fillimisht ja kisha kalua anëtarëve të Komisionit për Legjislacion në qoftë se dëshirojnë ta kenë fjalën dhe pastaj kalojmë tek të pranishmit. Faleminderit!

Kush e donë fjalën nga deputetët, po zoti Agim Ademaj.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetare!

Përsëendetje për të gjithë të pranishmit,

Nuk do të ju marrë shumë kohë.

E tha kryetarja ne vitin e kaluar kemi punua dy herë radhazi në ndryshim plotësim të projektligjit dhe është tërhequr nga Qeveria, kësaj radhe kemi Projektligj të ri për parandalimin e konfliktit të interesit.

Mendoj që edhe gjatë punimeve në grup punues do të kemi kohë edhe mundësi të gjithë të interesuarit t'i shfaqin mendimet e veta dhe konkretisht propozimet e tyre rreth këtij projektligji.

Konsiderohet një projektligj mjaftë i rëndësishëm.

Këtë që e tha kryetarja nuk do të kemi shumë probleme e kam fjalën si grup punues edhe herë e kaluar kemi punua edhe me kolegun Agim Aliun, në këtë grup punues është edhe Pal Lekaj po më duke dhe sot t'i dëgjojmë propozimet e juaja dhe të shohim orientimet se kah do i marrim rreth këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Ademaj!

A dëshiron dikush fjalën nga anëtarët e Komisionit, zoti Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëendetje për kolegët deputetë dhe të gjithë të pranishmit që sot janë pjesë e këtij dëgjimi publik.

Më vjen mirë që e kemi organizua këtë dëgjim publik në këtë formë, sado që duke pasur parasysh faktin se në këtë legjislaturë ky projektligj është një projektligj është dëgjuar më së shumti, po sigurisht se edhe ky dëgjim do të kontribuoj që ne të kemi një projektligj çfarë besoj se është paraparë në synimet dhe objektivat që të .. si projektligj por më e rëndësishme se gjithçka unë e kam thënë edhe në Komisionin për Legjislacion madje edhe nuk kam pranuar që të jem kryetar por për hir të asaj kam qenë në të tri grupet punuese sa është shqyrtuar në fazat e mëhershme ky projektligj kam pranuar që të jem dhe arsyeja është që më në fund ky projektligj me të vërtetë të kaloj. Prandaj, edhe kam kërkuar një lloj të them kushtimisht garancion nga Qeveria e Republikës së Kosovës se ky ligj më në fund nuk do të tërhiqet sepse është një përbuzje e punës së grupit punues, i Komisionit, i deputetëve në dy herët e kaluara ku ne kemi bërë një punë të jashtëzakonshme pa mohuar po për kundrazi.

Për të vlerësuar edhe punën e gjithë akterëve tjerë të agjencisë por edhe mekanizmave tjerë të cilët kanë qenë bashkë me ne dhe që kemi harmonizua qëndrimet dhe kemi përgatitur ato drafte apo ato amendamente së fundi kemi dorëzuar në seancë plenare në Kuvendin e Kosovës që të miratohet.

Mirëpo, për arsye në thojza të paditura, është tërhequr projektligji dy herë por megjithatë më vjen mirë që tashmë kemi një projektligj krejtësisht të ri dhe ky projektligj plotëson shumicën e amendamenteve që ne kemi paraparë gjatë fazave të mëhershme të punës që kemi bërë për Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Sigurisht se me këtë dëgjim publik do të ketë mundësi që të kemi edhe ndonjë amendament të ri ashtu siç kanë propozuar edhe kolegët tanë tjerë deputetë dhe në fund përveç të kemi miratimin e një projektligji që thonë në kuptimin e fjalës popullore e treta e vërteta sepse është e treta herë që po vije gjatë këtij legjislacioni ky projektligj e kemi edhe një projektligj të mirë.

Prandaj, uroj që së bashku t'i japim kontributin të gjithë që të kemi edhe një projektligj apo respektivisht një ligj të miratuar po të kemi edhe një projektligj të mirë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Aliu!

Fjalën e ka zonja Valdete Bajrami, anëtare e Komisionit.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje për të gjithë,

Pa dashtë me i përsëritë ato çka i thatë ju, unë besoj që sot do ta kemi një takim ku do të dalim edhe me rekomandimet konkrete sepse është më se e nevojshme që ky ligj të vazhdohet dhe të aprovohet në Kuvend, pasi që siç e dini shumica e funksionarëve kanë shumë pozita edhe nuk e dinë qysh po mujnë me i arrit qoftë edhe ministrat me i dalë në krye të gjitha punëve.

Prandaj, për me qenë sa më korrekt dhe për me pas një barazi ndoshta me të gjithë qytetarët është e domosdoshme që ky ligj të del sa më parë në Kuvend dhe

shpresojmë ashtu qysh edhe e potencoi zoti Aliu që Qeveria kësaj here të qëndroj dhe të mos ... tërheqjen.

Unë po ashtu edhe në Komision kam shprehë gaditshmërinë që kontributin tonë do ta japim gjithsesi, mirëpo shpresoj që ky ligj të jetë një ligj në të mirë e të gjithëve dhe të jetë i aplikueshëm se ne jemi dëshmitarë qëpo bëjmë ligje dhe vetë po i shkelim. Prandaj, të shpresojmë që ky ligj të jetë në favor të të gjitha palëve pa pasur diskriminime se në këtë rast ju e dini çfarë po ndodhë në vendin tonë me këto poste të cilat i kemi të shtuara të individëve të caktuara.

Prandaj, unë ju dëshiroj një punë të mbarë dhe të gjithë ata të cilët kanë kontribuu dhe do të kontribuojnë, dua t'i falënderoj nga kjo tryezë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Bajrami!

Në qoftë se nuk ka dikush tjetër nga anëtarët e Komisionit, po ja kaloj fjalën zotit Shaip Havolli, drejtor i Agjencionit kundër Korrupsionit.

Vetëm po dua me paraqit para jush faktin që ka qenë në këtë dëgjim publik e ftuar edhe ministria e Drejtësisë zonja Dhurata Hoxha, unë mendoj që ministrat kur procedojnë projektligje për Kuvend duhet të jenë të pranishëm që t'i prezantojnë dëgjimet publike këto projektligje sepse po vijnë nga dikasteret e tyre. Fakti që nuk vjen domethënë që ta analizojmë bashkë projektligjin është goxha shqetësues, nuk mjaftohemi si Komision për Legjislacion që të delegohen disa zyrtarë që për mendimin tim janë shumë korrekt për faktin se kanë qenë në secilin dëgjim publik dhe grupe punuese, por neve na duhet niveli politik dhe në këtë rast ministrja e Drejtësisë është dashur që të jetë e pranishme. Asnjëherë në dëgjimet publike nuk është e pranishme ministrja e Drejtësisë. Andaj mendoj që kjo është goxha problem dhe e pamundëson domethënë edhe punën e mirëfilli të Komisionit për Legjislacion.

Tash fjalën po ja kalojmë zotit Shaip Havolli.

SHAIP HAVOLLI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Siç e dini Agjencia Kundër Korrupsion e ka për obligim ligjor që ta trajtoj ose .. Ligjin për konfliktin e interesit.

Bazuar në formacionet dhe bazuar në punën e agjencisë me vite që nga fillimi i trajtimit të këtij ligji kemi hasur në shumë vështirësi gjatë zbatimit të këtyre ligjeve, nuk është e harmonizuar me dispozita ligjore të kodit penal po ashtu ka shumë zbrastira ligjore, ka pakjartësi në interpretime, në raport me ligj dhe institucione tjera, po edhe ashtu ka të bëjë edhe me aktivitete që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit ose me konflikt interesi në fushën e prokurimit, po ashtu janë bërë edhe disa që kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Tash bazuar gjatë punës të agjencisë kemi pasur shumë vështirësi të .. opinione, vendime lidhur me situata të caktuara të Ligjit të konfliktit të interesit.

Kemi situata kur Ligji mbi konfliktin e interesit nuk e jep një .. të caktuar, ndërsa ligjet ose normativat të brendshme të institucionet e rregullojnë këtë çështje dhe shpesh zyrtarët e lartë kërkojnë thonë ama interpretimin a jem ndesh me ligjin mbi konfliktin, nuk më intereson mua çka po merresh me punë të tjera të aspektit gjyqësor të legjislacionit.

Kështu që, besoj që me këto propozime të reja që vijnë nga ekspertë që ka prua Ministria e Drejtësisë nga Agjencia, ekspertë të GDP dhe të Këshillit të Evropës besoj që deri diku i kemi shpalos ose i kemi paraqitë të gjitha ato probleme që na paraqiten neve në praktikë gjatë zbatimit.

Përpos çështja e punësimeve të shumëfishta një çka është shumë me rëndësi besoj nëse i till kalon edhe çështja në kuadër edhe të institucioneve të ketë një zyre ligjore që trajton çështjen e konflikt interesi bazuar në hartimin e rregullave të brendshme si kodit ... edhe rregulla të brendshme ku agjencia do të ketë një rol inspektimi, një rol monitorimi por edhe një rol në aspektin të dhënieve të ekspertizave profesionale.

Po besoj që përkrahja e juaj si Komision nuk po mëngon deri tash, ne si agjenci jemi të kënaqur në të gjitha fushat jo në fushën e këtij ligji por edhe në aspekte të tjera.

Ne do të mundohemi me dhënë kontributin edhe në këtë dëgjim publik por edhe në çështje tjera. faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Havolli!

Kush e donë dikush tjetër nga të pranishmit fjalën, më fal Artan se nuk e pash dorën. Artan Demhasaj, nga Organizata “Çohu”.

ARTAN DEMHASAJ: Faleminderit, Albulena!

Çohu, e ka përcjell Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit qysh në fillim, qysh ka nis hartimi i ligjit të parë projektligjet tjera që kanë kaluar dhe janë rrëzuar në seancë, në vazhdimësi ne i kemi përcjell dhe kemi analizuar në detaje të gjitha projektligjet që kanë pasur të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik edhe si pasojë e kësaj që ne e kemi ndjek ndër vite ne i kemi tri pika kryesore që mendojmë që duhet t’i ketë ky ligj që në fakt tash nuk i ka.

E para është që ne mendojmë që duhet të ekzistojë kategorizimi i konfliktit të interesit karshi pozitave të zyrtarëve të lartë ne mendojmë që nuk duhet që të gjitha dispozitat që i ka tash ky projektligj të vlejë njëjtë për krejt zyrtarët, tu fillu prej presidentit që është pozicioni më i lartë i shtetit e deri tek ai zyrtari më i ulët që e kap ky ligj për ta parandaluar konfliktin e interesit. Pse mendojmë kështu? Kjo lidhet me pikën e tretë që ne e kemi për diskutim që ka të bëjë me sanksionimin e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, për shembull aty në sanksione thuhet që në rast se zyrtari ka papajtueshmëri duke u bazuar në këtë ligj, atëherë Departamenti për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore mundet të nxjerr vendim ku mundet t’ia ndalojë ushtrimin e funksionit zyrtarit prej 6 muaj deri në 2 vjet.

Tash, këtu shtrohet pyetja krejt për mungesë të kategorizimit të konfliktit a mundet Departamenti për Kundërvajtje që t’ia ndalojë ushtrimin e funksionit kryeministrit ose presidentit, deputetit që është i zgjedhur nga populli. Unë nuk mendoj sepse me Kushtetutë dhe me ligjet tjera kjo është e rregulluar në mënyra tjera. Domethënë,

deputetit nuk mundet të ia marr mandatin ose me ia ndalu ushtrimin e funksionit Departamenti për Kundërvajtje. Për atë arsye unë mendoj që ligji duhet fillimisht që të kategorizojë të paktën në dy kategori zyrtarët e lartë, sa i përket parandalimit të konfliktit të interesit. Kategoria e parë mundet me qenë kategoria politike, që janë të gjithë ata që janë zë zgjedhur, që janë deputetë, ministra, kryeministri, presidenti dhe kategoria tjetër që i përfshin shërbyesit civil që janë prej sekretarit të ministrisë e poshtë.

Kjo pastaj sqaron shumë çështje edhe mundet me e pru at pasojën pozitive që ligji mundet të implementohet sa duhet për shkak se unë mendoj që kjo dispozitë nuk mundet të implementohet në praktikë, sepse po e përsëris edhe njëherë nuk mundet gjykata ta ndalojë ushtrimin e funksionit as të deputetit, as të presidentit, dhe as të ministrave dhe të deputetëve.

Pjesa tjetër, që ne e konsiderojmë që është shumë me rëndësi që duhet me qenë pjesë e ligjit ka të bëjë me fshehjen e konfliktit të interesit ose refuzimin e zyrtarit për ta deklaruar konfliktin e interesit. Mendoj që kjo madje duhet të konsiderohet edhe vepër penale nëse zyrtari qëllimisht e fsheh konfliktin e interesit nuk e deklaron, madje refuzon që ta deklarojë konfliktin e interesit konsideroj që kjo duhet me qenë vepër penale për arsye, sepse ai qëllimisht po e bën edhe prej kësaj mundet me pas edhe përfitim. Kjo lidhet me një dispozitë që tash projektligji ka që është neni 22, pika 2 që është njëfarë lloj parashkrimi i ndjekjes së konfliktit të interesit që ligji ka paraparë që nëse shkelja ka ndodh dy vjet më herët atëherë agjencia e humb të drejtën për ta trajtuar këtë rast dhe njëfarë mënyre ky është parashkrim i lëndës.

Domethënë, kjo prapë është shumë negative, sepse nëse shkelja ose fshehja e konfliktit të interesit ka ekzistuar dy vjet më herët, atëherë agjencia nuk ka fare të drejtë që ta trajtojë këtë rast edhe në njëfarë mënyre është një parashkrim, është një amnistim i asaj shkelje se ka ndodh dy vjet më herët. Edhe njëherë po i përmbledh të tri këto çështje që janë shumë me rëndësi, sepse nuk dua të ndalem në dispozita të veçanta të ligjit, sepse këtë dua ta lë për grupin punues kur të fillon për secilin dispozitë qëndrimin tonë, po si pika të përgjithshme unë mendoj që duhet fillimisht të kategorizohet konflikti i interesit, të penalizohet fshehja e konfliktit me qëllim ose mos deklarimi i konfliktit dhe të sanksionimi, pra të rishikohet edhe njëherë

kjo mundësia që Departamenti për Kundërvajtje me pas të drejtën me e marr ose me e ndalu ushtrimin e funksionit.

Gjithashtu, te sanksionimi unë mendoj që masat ndëshkuese janë shumë të ulëta karshi me shkeljet që munden me ndodh. Sanksionimi më i madh aty është 1 mijë deri në 2 mijë euro masa ndëshkuese me gjobë. Unë e konsideroj që një pjesë e madhe e zyrtarëve munden qëllimisht me e pas papajtueshmëri me funksionin që e kanë edhe me gjithë dëshirë kanë për ta paguar gjobën maksimale që është 2 mijë euro, sepse nuk është një gjobë shumë e madhe që atyre mundet të i rëndojë.

Kështu që edhe te sanksionimi konsideroj që gjobat duhet të jenë shumë më të larta në mënyrë që me ua vështirësua sa më shumë zyrtarëve, atyre që kanë për qëllim me pas papajtueshmëri, ose thjeshtë me e fsheh konfliktin ose me vazhdu që të funksionojnë në një gjendje të konfliktit të interesit.

Unë mendoj që prapë se prapë nëse ligji do të kalojë pa këto tri parime kryesore nuk ka për të mundur që ta luaj at funksionin kyç që duhet ta ketë në parandalimin e shfaqjes së veprave korruptive edhe me qenë njëfarë parandaluesi i shfaqjes së korrupsionit në përgjithësi tek funksionet e larta publike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Demhasaj! A e dëshiron dikush fjalën nga të pranishmit? Nëse ende askush s'është përgatitur për fjalë vetëm po dua domethënë të ndalem pak te projektligji që është proceduar në komision, në Kuvend.

Për mua është goxha problem fakti që kur flitet për zyrtarët e lartë i njëjti referohet Projektligjit për deklarimin e pasurisë. Pra, në ligjin versionin aktual e kemi të kategorizuara se kush janë zyrtarët e lartë, ndërsa me këtë projektligj i referohet vetëm Ligjit për deklarim të pasurisë. Mendoj që Grupi Punues duhet të adresojë këtë çështje, pra ta vendosë siç ka qenë në ligjin aktual apo të i referohet Ligjit për deklarim qysh është propozuar edhe nga ministria. Pastaj, thuhet në njërën prej neneve thuhet që “personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje me ligj”, tash ne e dimë se sa shumë probleme kemi kur nuk specifikohen cilit ligj. Pra, ne duhet t'ia bëjmë të qartë kujt do qoftë që dëshiron ta zbatojë këtë ligj, për të paraqitur rastet e konfliktit të interesit cilit ligj

t'i referohet për shkak se ju e dini ne kemi një ligj në fuqi që është Ligji për mbrojtjen e informatorit, në fakt ai ligj ka mbet komplet i pazbatuar.

Domethënë, edhe nga institucionet publike ka mbet i pazbatuar për shumë rrethana, për shkak të frikës, kërcënimeve të ndryshme, mirëpo edhe për shkak që shumë prej zyrtarëve nuk janë në dijeni që ekziston ai ligj dhe që i mbron në rast se ata raportojnë një shkelje nëpër institucionet përkatëse. Tjetra, çka duhet të saktësohen edhe afatet, diku janë goxha të larta mendoj që duhet të shkurtohen afatet qysh janë paraqitur në këtë draft, por edhe në njërin prej neneve flitet për kufizimet që i kanë zyrtarët e lartë, pra ata nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e përmbaruesve, noterëve dhe falimentuesve. Domethënë, këtu nuk është fut edhe kategoria e ndërmjetësuesve, nuk e di pse mirëpo këtë pyetje e kam parashtruar edhe në seancë, por nuk mora përgjigje nga ministrja e Drejtësisë.

Pra, e pranoj që projektligji aktual është më i avancuar se sa ligji që kemi në fuqi, mirëpo megjithatë janë edhe disa çështje tjera, të cilat grupi punues duhet t'i ketë parasysh gjatë draftimit dhe amendamentimit. Kush e do fjalën nga të pranishmit? Po, zoti Edmond Dunga, nga Këshilli i Evropës.

EDMOND DUNGA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Faleminderit për mundësinë dhe për ftesën për këtë seancë dëgjimi për Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Desha pak të ndërlidhem edhe më herët siç e tha zoti Aliu, ka pasur iniciativa më herët edhe është punuar në këtë fushë me dy iniciativat e mëparshme, me qëllim që të bëhen ndryshme tek ligji ekzistues për parandalimin e konfliktit të interesit. Unë jam nga Këshilli i Evropës përfaqësoj projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër krimit ekonomik, i mirë përfshirë ngurtësisht në këtë proces bashkarish edhe me kolegët e zyrës së BE-së, këtu edhe nëpërmjet mekanizmit të LRM-së që merret me iniciativa të rëndësishme ligjore siç është edhe kjo.

Normalisht siç e tha zonja kryetare, ky projektligj ka përmirësime dhe ka ... me ligjin e mëparshëm, ligjin ekzistues, sepse Grupi i Punës është munduar në mënyrë të ngushtë të gjejë mundësi dhe përmirësime duke marrë praktikën e krahasueshme qoftë të rajonit edhe praktikën e mira evropiane në këtë fushë. Kuptohet bëhet fjalë për një çështje dhe një tematikë që ngre ende kundërshti, ka çështje që mund të përmirësohen më tej. Faktikisht siç e tha edhe drejtori i agjencisë zoti Havolli, Grupi i Punës nga Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia, kanë punuar në radhë të parë duke marrë parasysh praktikën, vështirësitë që kanë pasur me ligjin ekzistues, shtimin e disa dispozitave ose kufizimeve të reja dhe siç e kanë parë kolegët e nderuar, ky projektligj shtrinë në radhë të parë fushëveprimin sepse tani është i zbatueshëm për të gjithë zyrtarët publik.

Ligji ekzistues ka qenë vetëm për zyrtarët e lartë, sipas një liste që është e ngjashme me Ligjin e deklarimit të pasurive. Ndërkohë, që këtu kemi dispozita më shtrënguese dhe më kufizuese për zyrtarët e lartë në raste të caktuara, por është projektligj i zbatueshëm për të gjithë zyrtarët e çdo niveli duke marrë parasysh praktikën në këtë fushë që zbatohen.

Ndoshta mund të krijohej përshtjellim në fillim, por qëllimisht edhe janë harmonizuar të paktën terminologjitë edhe me Kodin Penal përkufizimet që të jenë të ngjashme dhe flitet për zyrtarët e lartë sipas logjikës së ligjit ekzistues dhe flitet për person zyrtar që janë të gjithë zyrtarët e tjerë sipas terminologjisë së Kodit Penal nenit 120 dhe termi i thjeshtuar në projektligj është zgjedhur "... zyrtarë" që i kam mbledh të dyja dhe aty ku ka dispozita specifike për zyrtarët e lartë specifikohet "lartë" kur ka të tjera për person zyrtar është "person zyrtar".

Diçka tjetër që është sqaruar dhe përmirësuar në këtë projektligj janë aspektet e qartësimit të kufizimeve, zonja kryetare përmendi edhe iniciativën për një amendament që mund të kufizonte. Është diskutuar gjatë çështja e pjesëmarrjes për shembull në borde publike që është një çështje e ndjeshme. Projektligji vendos një kufizim për këtë duke i lënë mundësinë ekzekutivit që përfaqësohet, sepse e ka detyrë ligjore dhe funksionale të përfaqësohet në borde, por një zyrtar nuk mund të përfaqësohet pafundësisht në shumë borde.

Për sa i përket amendamentit ka një pikë lidhje që mund të jetë neni 12, te pika 1. Në lidhje me mundësinë e punësimeve të dyfishta apo më tepër për zyrtarët, por neni përkatës i referohet zyrtarëve të lartë, pastaj është çështje tjetër e hapur nëse ky do të shtrihej edhe për zyrtarët e kategorive të tjera. Normalisht bashkarish me zyrën e BE-së është dhënë asistencë teknike dhe janë marrë praktikat e mira është marrë praktika e Grekos brenda Këshillit të Evropës që është grup i shteteve kundër korrupsionit që vlerëson shtetet anëtare, 49 shtete anëtare dhe mbi bazën e këtyre praktikave është arritur që të paktën të gjendet konsensus nga institucionet e përfshira për këtë projekt siç ka ardhur këtu.

Është e vërtetë që për sa i përket sanksioneve krijon një përshtypje që sanksionet ende në vlera absolute janë të ulëta, por kjo është edhe një çështje dhe problem ligjor, sepse ligji në fuqi për kundërvajtje ka vendosur një kufi i cili njëfarë mënyre duhet të harmonizohet nga ligjet speciale siç është edhe ky ligj dhe ai kufi është maksimumi që është gjetur tek sanksionet. Ndërsa, në lidhje me komentin e me shumë të drejtë që e dha kolegu nga “Çohu” kuptohet për funksionet e caktuara që kanë mandate mbi bazën e zgjedhjes ndoshta ajo dispozitë e sanksione shtesë mund të jetë e pazbatuar, por të paktën është e zbatuar aty ku ligji të zbatohet për pjesën tjetër, domethënë përjashtuar deputetët apo funksionet e zgjedhura të caktuara.

Ju e dini mirë që aktualisht që nga viti 2013, konflikti i interesit është edhe vepër penale në Kodin Penal, një nga rastet e rralla që e ka Kosova nuk ka shumë shtete të tilla që kanë dispozitë penale. Praktika nuk ka treguar shumë raste në këtë aspekt nëse zbatohet ose jo, faktikisht dhe praktikisht konflikti i interesit trajtohet në planin administrativ me masa të caktuara, masa dhe sanksione administrative përfshirë edhe masat me gjobë. Ka një risi me ligjin ekzistues, sepse në këtë ligj është vënë fokusi dhe theksi që për pjesën e zyrtarëve që shtohen, zyrtarët e tjerë jo zyrtarët e lartë i lihet përgjegjësi institucioneve dhe udhëheqësve të institucioneve që të merren me këto zyrtarë.

Meqenëse në dy iniciativat e mëparshme kam pas krijuar dhe vështirësi dhe probleme. Një problem lidhet me agjencinë që ju e keni edhe si agjenci të pavarur dhe e mbikëqyrni. Agjencia ka mundësitë e veta, por nuk mund të jetë përgjegjëse për të gjithë numrin e zyrtarëve 78 mijë apo 80 mijë zyrtarë që ka Kosova. Kështu

që është gjetur zgjidhja që për zyrtarët e tjerë dhe përgjithësi institucioneve, zyrtarët e lartë vazhdon logjika si deklaram i pasurive.

Në lidhje me listën në fillim është çështje teknike, domethënë anëtarët e grupit kanë propozuar që t'i bëhej referim Ligjit të deklaramit të pasurive me qëllim që nëse do të ndryshohet Ligji i deklaramit ky është i zbatueshëm edhe tek ky ligj. Nëse do të kishte ndryshime të mëtejshme Ligji i deklaramit do të thoshte që duhet të ndryshohet edhe këtu lista. Domethënë të dyja mundësitë janë të hapura, ekzistojnë si mundësi teknike. Një opsion që është zgjedhur, është zgjedhur që t'i bëhet referimi dhe sa herë të ndryshojë ai ligj vlen edhe për këtë, për listën e zyrtarëve të lartë. Ka pasur çështje dhe mbeten disa çështje për shembull, dua të përmend vetëm një shembull që ka të bëjë me besimin e verbër që është një institut kryesisht anglo-.... ky është futur edhe në ligjin ekzistues pavarësisht vështirësive që ka në praktikë që do të thotë zyrtari duhet të ketë një person të besuar ku kalon në mënyrë administrimi i të gjithë aseteve ose interesat private që ka para se të bëhej zyrtar.

Për vetë faktin dhe kontekstin që Kosova është ... i vogël, ka pasur dhe vështirësi praktike që anëtarët e grupit nuk e kanë marrë përkufizimin e plotë siç është "besimi i verbër", pra personi i besuar s'duhet të jetë as i afërmi, as bashkëshorti, as fëmija, as vëllai, as motra. Kjo domethënë nuk është marrë përkufizimi i plotë, është marrë një përkufizim që t'i përshtatej realitetit këtu, por kushti i kësaj do të ishte që të shtohet më tepër transparenca me qëllim që çdo veprim që bëhet pastaj nga personi i besuar do të ishte detyrim për tu njoftuar me institucionin ku është zyrtar.

Shtimi i transparencës do të bënte një balancim fakti që nuk ka domethënë një përkufizim, nuk i përmbledh të gjithë. Aty përkufizimi përmbledh domethënë një pjesë të praktikës ose të institutit të besimit të verbër, por është marrë parasysh edhe kontesti praktik. Ka qartësime ose lidhje me kompetencat e agjencisë dhe ndërlidhja e kompetencave të agjencisë me institucionet publike. Kjo është shumë e rëndësishme nëse ky ligj do të duhej të implementohet në praktikë do të duhej që të kishte qartësi që institucionet marrin përgjegjësitë e veta për zyrtarët që kanë brenda institucionit ose institucionin mbikëqyrës, në rastin e agjencive për shembull që mbikëqyren nga Kuvendi dhe agjencia si institucion koordinues

qendror në këtë aspekt të ndërlidhet me institucionet në çdo rast praktik dhe të jap ndihmën dhe asistencën e vetë, por edhe të mbikëqyrë çështjen e parregullsive apo shkeljeve që mund të ndodhin.

Një meqë mu dha mundësia, komenti tjetër interesant nga kolegu Demëhasaj nga “Çohu” ekziston edhe mundësia teknike që të bëhej kategorizimi i detyrimeve për konfliktin e interesit për kategoritë e caktuara të zyrtarëve. Në këtë stad grupi nuk ka arrit domethënë që të bëjë këtë lloj kategorizimi, kemi një shembull që është për shembull në Ligjin e Shqipërisë, ka një kategorizim, kufizimesh apo detyrimesh për zyrtarë të ndryshëm, kur janë pjesë të kabinetit, kur janë deputetë, kur janë drejtues të institucioneve. Përgjegjësisht praktika e krahasuar tregon që ose ndiqet një logjikë e ngjashme për zyrtarët e kategorive të ngjashme, pra zyrtarët në përgjithësi ose zyrtarët e lartë. Në shumë praktika të vendeve të BE-së, ose i tërë ligji pastaj duhet të niset dhe të bëhet i konceptuar me kategorizim. Ndërkohë, që ligji ekzistues ka pasur domethënë logjikën e detyrimeve ose ka dispozita nga ligji ekzistues me detyrime, ligji i ri është nisur si projekt ndryshim dhe me ndryshimet e bëra u arrit që të bëhej ligji i ri, sepse kishte shumë më tepër ndryshime nga ato që ishin paramenduar me dy draftet e mëparshme. Zoti Aliu e mban mend kur është punuar me dy të mëparshmet.

Kështu që, ka disa çështje të hapura, prandaj edhe është mundësia dhe diskutimi, komisioni ka hapësirën që të... por, në përgjithësi projektligji ka një avancim në raport me ligjin ekzistues. Shpresojmë që të gjitha çfarë mund të kishte... ne jemi të gatshëm në pikëpamjen e projektit që të asistojmë në këtë proces, siç jemi edhe të gatshëm me atë që zonja kryetare është shprehur për ligjin për mbrojtjen e informatorëve, që fillimisht ka qenë vënë në draft referimi i qartë, pastaj është bërë sipas ligjit në përgjithësi, që është një ligj që nuk zbatohet në praktikë dhe normalisht do të duhej të konsiderohej edhe ai një rishikim i mundshëm, sepse plotëson në përgjithësi kornizën parandaluese ligjore në këtë aspekt. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Dunga. A e dëshiron dikush tjetër fjalën? Po. Ju lutem vetëm prezantohuni për shkak të transkriptit.

RINOR HOXHA: Faleminderit, zonja kryetare!
Jam Rinor Hoxha, zyrtar ligjor nga OSBE.

Ne si OSBE kemi marrë pjesë në procesin e hartimit të këtij projektligji në nivel të Qeverisë dhe dëshiroj ta shfrytëzoj rastin për ta lavdëruar në njëfarë mënyre Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, sepse e kanë bërë një proces me të vërtetë të gjerë të konsultimit publik, ku të gjithë aktorët relevantë janë konsultuar.

Në pikëpamjen tonë të ekspertizës ligjore ky projektligj është një avancim në versionet tjera, të cilat janë prezantuar më herët nga ministria në Kuvend, por edhe me ligjin aktual. Parimisht, ne si OSBE mendojmë që projektligji është në përputhje me parimet dhe standardet dhe rekomandimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe OSCE-a, për të cilat përfaqësuesi i Këshillit të Evropës, përfaqësuesi nga Projekti i Këshillit të Evropës, i përmendi. Mirëpo, mendojmë se ka disa zbrazëti ligjore, për shembull, lidhur me definicionet. Definicioni i interesit privat të zyrtarit publik është shumë ngushtë i definuar në krahasim me atë që rekomandohet nga Këshilli i Evropës, pastaj nuk kemi definim për marrëdhënien afariste apo biznesore, e cila përmendet shpesh gjatë neneve të projektligjit, por edhe kemi edhe komente tjera lidhur me deklarin e konfliktit të interesit, që e përmendi përfaqësuesi i Çohu, mandej propozimi ynë është që në deklarin të konfliktit të interesit të përfshihen edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe anëtarët e asambleve komunale, në rastet kur iniciojnë apo marrin pjesë në diskutime për projektligje.

Gjithashtu, kemi edhe komente specifike që lidhen me sanksionet dhe me masat disiplinore aty, mirëpo të gjitha këto komente për të mos e zgjatur sot më shumë, do të kishim pasur dëshirë me i prezantua gjatë takimit të grupit punues, pasi që janë komente specifike, që lidhen me nene të caktuara të projektligjit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Hoxha.

Tash bashkërisht, domethënë edhe me anëtarët e komisionit e definojmë një afat kohor, prej kur së pari duhet t'i dorëzoni me shkrim të gjitha komentet që i keni, pastaj për t'i mbrojtur dhe shqyrtuar ato në grupet e punës. Zoti Florent.

FLORENT SPAHIJA: Përshëndetje!

Unë jam Florent Spahija prej KDI-së, Instituci Demokratik i Kosovës e ka përcjellë ligjin, faktikisht projektligjin, edhe në fazat kur ka qenë derisa është shqyrtuar pranë ministrisë.

Kemi marrë pjesë në takime të organizuara dhe kemi qenë pjesë e atij grupi. Kemi dhënë komentet tona, shumica nga ato janë marrë për bazë nga ministria dhe deri diku jemi, me aq sa kemi pa kur ka dalë projektligji final në fund, jemi goxha të kënaqur.

Kemi disa komente të vogla për disa ndryshime. normalisht, pajtohem me pjesën e Artanit, që deklaroi lidhur me atë pjesën, sidomos të sanksionet dhe konfliktin që mund të na rrjedhë prej zyrtarëve të lartë, ata që janë të zgjedhur.

Përndryshe, pjesën tjetër do ta transmetojmë me shkrim, normalisht në afatin që e përcakton komisioni. Faleminderit!

KRYETARJA: A ka dikush tjetër që e dëshiron fjalën? Po. Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën, pastaj përfaqësuesi nga Doganat.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë, zonja kryetare!

Unë nuk kam pasur shumë kohë me pa tekstin e këtij projektligji, por megjithatë diçka që vërejtja unë në krejt tekstin, sa munda ta lexoj, mungon përcaktimi i kategorisë kohë. përcaktimi i kategorisë kohë do të thotë brenda një orari të punës një person mund ta kryejë një vepër penale, ose një vepër për kundërvajtje.

Kjo do të thotë prej zyrës së vet, në orar të punës, me mjetet e institucionit, gjatë orarit të punës, kryen punët që nuk përkasin me vendin dhe orarin e punës. Dhe, kjo nuk është përkufizuar, unë sa vërejtja, nuk është përkufizuar askund. Në të vërtetë kjo është pjesa kryesore, sipas mendimit tim, e krejt shkeljes që mund të bëhet, natyrisht sa i përket konfliktit të interesit. i përçolla edhe diskutimet tjera, ka shumë propozime të mira, që më pëlqejnë, por më duket se kjo mungon tërësisht në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Kurteshi. Përfaqësuesi nga Dogana. Prezantohuni ju lutem!

DRITON MUSTAFA: Faleminderit!

Jam Driton Mustafa.

Sot e përfaqësoj Doganën e Kosovës dhe falënderoj që na keni dhënë mundësinë për të marrë pjesë dhe për t'i dhënë komentet tona!

Unë i kam disa komente, sidomos te neni 3, te paragrafi 1.2, ku mendoj se te interesi privat janë të përfshirë vetëm personat e afërm. Ishte dashur të zgjerohet ky koncept, të përfshihen edhe persona të tjerë, nëse ka konflikt interesi. Sepse, shpeshherë ndodhë që një shkelës apo kundërvajtës nga ajo shkelje që buron prej konfliktit të interesit, të përfitojnë edhe persona të tjerë, jo vetëm persona të afërm të zyrtarit.

Po te i njëjti nen, domethënë te pika 3, te definomi i zyrtarit të lartë, unë mendoj se definomi duhet të bëhet pikërisht në këtë ligj. Ie të përcaktohen saktë kush janë persona apo zyrtarë të lartë publik, taksativisht, në mënyrë që gjatë zbatimit të këtij ligji të mos ketë nevojë të kalohet prej një ligji në një tjetër, më konkretisht të kalohet te ligji mbi deklarin dhe prejardhjen e pasurisë, se ky është një ligj i veçantë dhe në këtë rast po e rregullon një çështje shumë të veçantë. Mendoj se kategorizimi duhet të bëhet në këtë ligj, sepse sigurisht se edhe efekti edukues do të jetë më i madh.

Më konkretisht, nëse një person apo një zyrtar publik dyshon se ka konflikt interesi, atëherë ai do të ishte mirë që ta gjente pozicionin e vet pikërisht në këtë ligj, jo të thirrej te ligji tjetër, për shembull, për deklarin dhe pasurisë apo të thirret te ndihma, asistencë që do të kërkonte nga Agjencia Kundër Korrupsionit, se në këtë formë do t'i ngarkonte agjencinë tej mase me sqarime të përditshme.

Te neni 3, paragrafi 1.9, zotërimi pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital, mendoj se duhet të ridefinohet, sepse është një pozicion shumë interesant. Të përmendi, që “pronari ruan të drejtën e përfitimit të ... pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vet asnjë veprim mbi atë pronë.

Ky pozicion do t'i krijonte mundësinë një zyrtari të lartë publik, që të përfitonte nga një veprim, mirëpo të mos marrë përgjegjësi efektive, për shembull, në menaxhimin e një ndërmarrjeje, ose të tillë. Kjo duhet të ridefinohet, duhet të

qartësohet, se është e pamundur të përfitojë një person apo një zyrtar i lartë publik prej një pozicioni në ndërmarrje apo prej ndonjë veprimi e të mos ketë forcë ekzekutive vendimmarrëse.

Këto janë komentet që kanë të bëjnë me nenin 2.

Sa i përket nenit 8, përmendet disa herë “Agjencia...”. është mirë me e qartësua a është Agjencia Kundër Korrupsionit apo... se Agjenci është term shumë i gjerë, ne kemi shumë agjenci në Kosovë, kemi me dhjetëra ndoshta. Le të përmendet taksativisht, “Agjencia Kundër Korrupsionit”, jo vetëm Agjencia. Të tjera komente nuk kam. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Afrim.

AFRIM HATASHI: Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Afrim Hatashi!

Vij nga departamenti i parandalimit të korrupsionit, ku bën pjesë edhe Divizioni për Parandalim Konflikti të Interesit.

Desha të ndërhyj pak me këtë kategorizimin e zyrtarëve të lartë publikë, të sqaroj, sepse pikërisht ky ligj mendoj se ka kategorizuar, tash ne... u përmendën shumë kategorizime që mund të diskutohen a të ndryshohen ose jo, por pikërisht ky ligj i ka ndarë pak.

Nëse kthehemi në retrospektivë prapa, shohim se Ligji për zyrtarë të lartë publikë kategoria ka qenë e njëjtë, sikur për Ligj për deklarim të pasurisë, po ashtu edhe për Ligjin për parandalim të konfliktit të interesit, domethënë kanë qenë të njëjtë. Mirëpo, Ligji për parandalim të konfliktit të interesit nuk ka ndryshuar, ndërsa Ligji për deklarim të pasurisë ka ndryshuar dhe tash, për shembull, Ligji për deklarim të pasurisë i ka zgjeruar një rrjet zyrtarësh publikë, ndërsa Ligji aktual për parandalim të konfliktit të interesit nuk është ndryshuar dhe kanë mbetur ata zyrtarë të njëjtë. Dhe, ne kemi pasur problem edhe në rastet e trajtimeve të rasteve kur për shembull, në deklarim të pasurisë ata janë zyrtarë të lartë publikë, ndërsa për konflikt interesi nuk janë dhe kështu kemi ardhur në lajthitje. Qëllimi i kësaj ka qenë, se pa marrë parasysh sa herë ndryshohet Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave apo qysh të vijë situata, me u thirr gjithmonë në Ligjin për deklarimin e pasurisë dhe ata zyrtarë që janë ata mbasin gjithmonë. A ndryshohet një herë Ligji

për deklarin, a dy herë, a tre, ata zyrtarë që konsiderohen sipas Ligjit për deklarin të pasurisë, që janë zyrtarët publikë, me qenë edhe për Ligjin e konfliktit të interesit dhe pikërisht kjo për të mos ardhur në dilema se cili funksion, cila pozitë, veç i referohet asaj nenit të deklarimit të pasurisë dhe është shumë e qartë.

Edhe kategorizimi tjetër që është bërë, është pikërisht që e përmendi edhe Dunga më herët, po edhe drejtori e të gjithë që e përmendën, se ne e kemi shtruar nivelin për t'i trajtuar edhe zyrtarët që janë në nivel më poshtë dhe ata i trajtojmë në një mënyrë tjetër, ndërsa zyrtarët e lartë në një mënyrë tjetër, që kanë kufizime të tjera, mospërputhje të funksioneve e krejt. Dhe, kjo është kategorizimi që është bërë në këtë ligjin apo projektligjin aktual.

Mendoj që është e drejtë kjo mënyrë që është bërë dhe është e mirë, se gjithmonë edhe tash na i kemi edhe në koncept-dokument edhe Ligjin për Agjencinë, ndoshta edhe ligjin për deklarin ata mund të ndryshojnë prapë dhe gjithmonë ligji për konflikt u referohet atyre, pa marrë parasysh qysh ndodh.

Zyrtarët tjerë që janë veç zyrtarë trajtohen në mënyrën qysh i kemi paraparë, zyrtarët e lartë janë në mënyrën qysh janë paraparë dhe nuk ka shumë paqartësi në këtë aspekt.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Hatashi! Po. Dren, nga grupi për studime juridike dhe politike.

DREN: Faleminderit!

Më prezantoi kryetarja Haxhiu! Ne si grup kemi qenë pjesë e një punëtorie të cilën e pat organizuar Ministria e Drejtësisë së bashku me Agjencinë kundër korrupsionit. Një ndër pikat që u pat diskutua aty, ka qenë edhe puna e personit të besuar, tek çështja e transferimit të së drejtave në drejtimin e ndërmarrjes. Aty e patëm biseduar për shkak se tek shprehja person i besuar nuk futen anëtarët e ngushtë të familjes dhe diskutimi, nëse nuk harroj, ka pas qenë se a kanë të drejtë edhe personat e afërm me udhëheq me ndërmarrjen të cilën e ka pasur për shembull zyrtari i lartë publik.

E patëm diskutuar rastin, që duke e ditur ekonominë tonë zakonisht janë ekonomi të vogla, ekonomi familjare, të cilat zakonisht i udhëheq burri e gruaja, në rast se nesër pasnesër ai bëhet këshilltar politik, sa do të mund të përshtatej atij mentaliteti në punë që me i besua një personi i cili nuk është anëtar i familjes, kur dihet të gjithë ndërmarrjet i ndërtojmë si ekonomi familjare. E patëm diskutuar si rast. Ekspertja prej Sllovenie ka qenë kundër, sepse thoshte se është praktikë, në vendet tjera që anëtarët e ngushtë, personat e afërm, mos me e marrë drejtimin e ndërmarrjes. Mirëpo, mua më intereson rast ynë, sa do të ishte zbatueshme kjo? Atëherë, personi i besueshëm do të emërohej vetëm si person formal, sa për të figuruar në letër, kurse faktikisht krejt udhëheqjen e biznesit prapë do ta bënte anëtari i familjes.

Besoj se duhet edhe një herë rishikuar çështjen e këtyre rasteve. Nëse bën me e marr edhe një shembull, është edhe rasti tash i presidentit Trump, i cili krejt biznesin e tij ua ka besuar fëmijëve të vet. është mirë me e diskutua edhe një herë dhe me ua përshtat rrethanave tona ekonomike, sepse do të ishte shumë vështirë me e gjet një person të cilit ti i beson për të ta udhëhequr ndërmarrjen tënde, kur ti faktikisht e ke ndërtuar krejt biznesin bashkë me familjen tënde, vëllezërit tu, motrat tua, e kështu me radhë. Por, prapë nëse shihet se ka ndonjë konflikt, ose diçka të ngjashme me mbet kështu siç është.

Kjo është dilema të cilën ne e kemi diskutuar. Natyrisht, që edhe në grupin punues do të japim kontributin tonë në këtë projektligj.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Ajeti. Aa ka dikush tjetër që e dëshiron fjalën? Nëse jo, njëherë po ia kaloj fjalën zotit Ademaj.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetare! Jo, nuk kam diçka rreth komenteve. Përafërsisht e kemi orientimin. Unë thash në fillim, na ka ndihmuar ajo që kemi punuar vitin e kaluar. Më gëzon fakti, se edhe gjatë procesit nëpër ministri sa ka kaluar diskutimet publike, shihet se është punuar, ka komente. Ne i kemi marrë edhe bashkëngjitur me projektligjin komentet që i kanë dhënë përfaqësuesit e OSBE-se edhe disa prej të cilave janë pranuar.

Unë ju kisha lutur që, po më duket deri javën e ardhshme Agim, mund t'i presim rreth komenteve nëse kanë le t'i dorëzojnë me shkrim. Nuk jam për ta vonuar punën në grupe pune, domethënë mund të startojmë javën tjetër, por varet tash prej juve sa do të jeni efikas në propozimet e juaja, që t'i dorëzoni me shkrim, sepse është më lehtë të punojmë. I kisha lutur ata që kanë punuar më intensivisht gjatë procesit me Ministrinë, nëse i kanë kryer komentet edhe janë marrë shumica e tyre, ose tërësisht vërejtjet e tyre, mos t'i dyfishojnë ato propozime. Duhet të kemi kujdes të mos e humbim edhe vetë qëllimin e projektligjit, nëse bëjmë ndërhyrje shumë të mëdha në të, ose ide krejt tjera, atëherë dalim prej atij konceptit logjik, që ministria ka punuar me ekspertë dhe mbështetës në këtë projektligj.

Ne jemi të gatshëm si grup punues prej javës tjetër të startojmë të punojmë pa asnjë problem, po e them, nëse ju mund të caktoni një afat kur mund t'i dorëzoni propozimet e juaja me shkrim te stafi mbështetës i komisionit.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Ademaj! Faleminderit, po ashtu edhe për komentet. Natyrisht, që këto duhet dhe do të diskutohen në punën që do ta bëjë grupi punues.

Unë mendoj që është i mjaftueshëm afati deri të hënën, në qoftë se keni kundërshti, jo. Artani po e kundërshton. Të martën? Të hënën s'punohet, dakord. Të mërkurën, sot një javë. Pra, deri më 18 prill t'i dërgoni në Komisionin për Legjislacion komentet lidhur me projektligjin dhe pas të mërkurës, pastaj grupi punues do të mblidhet dhe do t'i shqyrtojë dhe do t'i analizojë komentet që i keni dërguar. Pra, edhe një herë, në emër të komisionit ju falënderoj për kontributin. Nesër e kemi dëgjimin publik për Projektligjin për trashëgiminë në Kosovë, është natyrisht edhe ai i rëndësishëm dhe ata që kanë interes, ndonëse jeni ftuar, ju lus të jeni të pranishëm. Faleminderit!